



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



**API**

Agjencia për Pronësi Industriale  
Agencija za Industrijsku Svojину  
Industrial Property Agency

# RAPORT VJETOR 2021

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 200 36 554  
Web: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

## 1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët


Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin e aplikimeve për objekte të pronësisë industriale, si: Marka Tregtare; Patenta; Dizajne Industriale; kundërshtime të markave të publikuara; hulumtime të markave tregtare; aplikime për patenta; ekzaminime të parakohshme; vazhdime të markave tregtare; ndryshime në regjistër; kërkesa për mbajtje në fuqi; dokumente të përparësisë; ndërrim përfaqësuesi; autorizime gjenerale; ankesa në komision të ankesave; vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Gjatë kësaj periudhe kohore në zyrën e pranimin të dokumentacionit të API-së janë pranuar **7027** kërkesa të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Marka Tregtare aplikime	<b>1950</b>
Patenta aplikime	<b>16</b>
Dizajn Industriale aplikime	<b>31</b>
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	<b>1205</b>
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	<b>871</b>
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	<b>1906</b>
Kërkesa për kufizimin e listës së produkteve	<b>20</b>
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të markave tregtare	<b>15</b>
Autorizime	<b>167</b>
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	<b>277</b>
Kundërshtime të Markave Tregtare	<b>97</b>
Kërkesa për tërheqje kundërshtimi	<b>4</b>
Kërkesa për heqje dorë të markave tregtare dhe patentave	<b>20</b>
Kërkesa për korrigjimin e vendimeve dhe aplikimeve	<b>148</b>
Kërkesa për ekstrakt regjistri	<b>16</b>
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	<b>11</b>
Dokumente prioriteti	<b>94</b>
Kërkesa për informacione të markave tregtare dhe patentave	<b>50</b>
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	<b>32</b>
Ankesa kundër vendimeve të API-së	<b>14</b>
Kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare	<b>4</b>
Vendim i komisionit të ankesave	<b>9</b>
Kërkesa për rivendosje të MT	<b>13</b>
Kërkesa nga pala	<b>46</b>

Kërkesa për licencë marke	1
Kërkesë për shpalljen e pavlefshmërinë e dizajnit industrial	5
Tërheqje kundërshtimi	4
Përgjigje në kërkesën për pavlefshmëri të dizajnit industrial	1

Tabela 1. Numri i dokumenteve hyrëse, Janar-Dhjetor 2021




## 2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

### Patenta

Numri i aplikimeve të patentave vazhdon të jetë në nivelin e ulët, kjo për shkakun e mos anëtarësimit të Kosovës në EPO (Zyra Europiane e Patentave), dhe industrisë jo të zhvilluar inovative e cila lidhet me aplikimin e patentave me aplikues vendor. Me rastin e anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave, pritet të rritet numri i aplikimeve për patenta, kjo pasi zvogëlohet kostoja dhe koha e aplikimit, duke krahasuar me mbrojtjen nacionale që aplikohet tashmë në Kosovë.

Ekzaminimi i aplikimeve për patenta kryhet brenda 18 muajve, duke llogaritur nga data e dorëzimit të aplikimit për patentë. Pronari i patentës është i obliguar të dorëzoj dëshmi me shkrim që shpikja është e patentuar, është e re dhe ka hap shpikës, më së voni pas skadimit të vitit të nëntë të afatit të patentës së dhënë nga Agjencia.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	<b>16</b>
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	<b>14</b>
Vendim për njohjen e patentës	<b>13</b>
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	<b>1</b>
Hulumtime në regjistrin e patentave	<b>21</b>
Hapa në sistemin IPAS	<b>3518</b>
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	<b>275</b>
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	<b>256</b>

*Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2021*


### Marka Tregtare

Numri i aplikimeve për marka tregtare vazhdon të mbajë trendin dhe mesataren e njëjtë të aplikimeve në vite, ndërsa numri i aplikimeve me aplikues vendor ka shënuar rritje.

Kjo rritje i atribuohet aktiviteteve promovuese të mbajtura nga Agjencia dhe Projekti i Mbështetës EUIPR ne Kosove, projekt tre vjeçar i financuar nga Bashkimi Evropian.

API ka vazhduar me shqyrtimin e aplikimeve për marka tregtare ku janë përfunduar shqyrtimet e aplikimeve paraprake, dhe po vazhdohet me shqyrtimet e aplikimeve të markave tregtare të pranuar gjatë vitit 2021.

Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesën për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit për regjistrimin e një markë tregtare. Regjistrimi i një marke tregtare në Agjenci për aplikimet të cilat nuk pranojnë kundërshtime bëhet në kohë relativisht të shpejtë krahasuar me kohën e ekzaminimit të aplikimeve nga vendet rajonale apo të tjera.



Vendime për regjistrimin e markave tregtare	<b>1439</b>
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	<b>1887</b>
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	<b>129</b>
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	<b>19</b>
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare	<b>1007</b>
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	<b>1174</b>
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	<b>1371</b>
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	<b>1533</b>
Ekstrakte regjistri	<b>16</b>
Vendime për refuzimin e MT	<b>18</b>
Ftesa për përgjigje në kundërshtimin e markave tregtare	<b>66</b>


Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare gjeneruar përmes IPAS

### Dizajni Industrial

Si tek aplikimet për patenta ashtu dhe tek aplikimet për dizajn industrial, numri i aplikimeve nuk është i kënaqshëm, kjo për shkakun e zhvillimit industrial që korrespondon me zhvillimin e produkteve të reja në Kosovë. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit. Produkti duhet të ketë karakter individual dhe të jetë i ri në fushën përkatëse.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	6
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial	7
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	6
Certifikata për Dizajnin Industrial	2
Ftese për pagesën e regjistrimit të DZ	15

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial



### Përmbledhja statistikore e punës vjetore

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2021 kanë kryer gjithsejti **24224** hapa në sistem. Hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.

Janë lëshuar **6770** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server **13647** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të nga forma elektronike shume me te lehte dhe shpejte.

### **3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklarim të shfuqizimit**

Për ti trajtuar kërkesat për kundërshtime dhe kërkesat për shfuqizimin e markave tregtare, Agjencia ka përgatitur Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Agjencinë për Pronësi Industriale. Në këtë Rregullore është parashikuar formimi i Divizionit Juridik i cili do të merret me shqyrtimin e kërkesave për kundërshtime dhe kërkesat për deklarimin e shfuqizimit të markave tregtare.

Gjatë vitit 2021 në Agjencinë për Pronësi Industriale janë pranuar 89 kërkesa për kundërshtimin e markave tregtare dhe 3 kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare të regjistruara dhe 6 kërkesa për shpalljen e pavlefshme të dizajnit Industrial.

Agjencia për Pronësi Industriale ka filluar iniciimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të tilla, që konsiderohet procedura formale, ku gjatë këtij viti kalendarik ka lëshuar njoftime për përgjigje në kërkesat për kundërshtimin e markave tregtare. Pas përgjigjes së aplikuesit në kërkesën për kundërshtimin e markës tregtare, bëhet shqyrtimi përmbajtjesor i kërkesës dhe vendoset mbi regjistrimin apo jo të markës tregtare të aplikuar.

#### 4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **8** Buletine Zyrtare me **5198** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, vazhdimet e markave tregtare, regjistrimet e patentave dhe dizajnit industrial.

Duke u mbështetur në buletin, pronarët e markave të mëhershme të cekur në nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 04/L-026 mund të paraqesin kundërshtimet e tyre. Këto kundërshtime duhet të dorëzohen brenda periudhës kur Buletini Zyrtar është i hapur apo brenda 3 muajve nga data e publikimit të Buletinit Zyrtar.

Përveç Buletinit, Agjencia në ueb faqen e saj publikon dhe regjistrin online ku publiku mund të kërkojë për objekte të pronësisë industriale dhe aplikuesit mund të shikojnë procesin e shqyrtimit të aplikacionit të tyre.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>



## 5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Ka vazhduar përditësimi i regjistrit online për objektet e pronësisë industriale. Ky regjistër përditësohet çdo ditë kalendarike. Sipas legjislacionit, markat tregtare publikohen nga momenti i aplikimit ndërsa patentat dhe dizajnet industriale publikohen në regjistër vetëm pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Buletinin Zyrtar.



The screenshot displays the homepage of the KIPA (Kosovo Intellectual Property Agency) search system. The main heading is "SISTEMI I KËRKIMIT TË AGJENCISË PËR PRONËSI INDUSTRIALE" (Search System of the Agency for Industrial Property). Below this, it specifies "Patentat, Dizajnat Industriale dhe Markat Tregtare të depozituara në Kosovë" (Patents, Industrial Designs and Trademarks deposited in Kosovo). The page features a navigation menu with "Dizajn", "Patenta", and "Marka tregtare". A search bar is present with the text "PATENTA, DIZAJN INDUSTRIALË DHE MARKAT TREGTARE TË DEPOZITUARA NË KOSOVË". Below the search bar, there are filters for "Flamuri" (Flag) and "Shteti" (Country), both set to "Kosova". To the right, there are three buttons showing counts: "Patenta" (1005), "Dizajn" (33), and "Marka Tregtare" (35413). At the bottom, there is a search bar with "KËRKO" (Search) and "EXPORTO" (Export) options. The footer includes the WIPO logo and the text "powered by WIPO".

Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2021 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **29** lajme dhe publikuar në web faqen [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net).



## 6. Seminare & Aktivitete

Agjencia për Pronësi Industriale mirëpriti disa studentë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Ferizajt, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajni i Interierit me Prodhime nga Druri. Drejtori i Agjencisë, Z. Gashi, mbajti një ligjërata për studentët, ku i informoi ata mbi mbrojtjen dhe rëndësinë e pronësisë intelektuale, me theks pronësinë industriale.




U mbajt sesi informues në Qendrën për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Universitetin e Prishtinës. Qendra për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Universitetin e Prishtinës, “Venture UP” në bashkëpunim me Agjencinë për Pronësi Industriale, organizoi sesionin informues mbi pronësinë industriale.

U publikua broshura “Pronësia Intelektuale për Afaristët. Projekti i EU për fuqizimin e pronësisë intelektuale ka përgatitur broshurën e pronësisë intelektuale për afaristët.

Kjo broshurë është hartuar me synim të ndihmojë pronarët e bizneseve, përfaqësuesit e ndërmarrjeve dhe NVM-ve nga Kosova, me informata konkrete të paraqitura në mënyrë sa më të përshtatshme për përdoruesit, për të kuptuar sa më mire rëndësinë e pronësisë intelektuale. Linku për qasje në broshurën <https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/699FEB98-5168-4475-A700-ACB6B8C2ED2C.pdf>



Janë mbajtur takimet e rregullta të Komitetit Drejtues të Projektit IPR të EU. Janë mbajtur takimet e 3 dhe 4 me radhë. Në takim diskutohet mbi realizimin e aktiviteteve të projektit dhe vështirësitë në realizimin e aktiviteteve. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar shumë aktivitete si reforma ligjore, fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe promovimi i pronësisë intelektuale.



U mbajt takimi sektorial për vreshtari dhe veretari. Drejtori i Agjencisë, Z. Gashi, mori pjesën në takimin e rregullt të organizuar nga Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në takim u diskutuan të dhënat e fundit sektoriale në Vreshtari dhe Vertari, të cilat përfshinë deklaratimet apo raportet nga viti 2020, aplikacioni për Treguesit Gjeografikë për verën “Rahoveci” dhe diskutimet mbi harmonizimin e bazës ligjore në raport me zhvillimet e sektorit të vreshtarisë dhe vertarisë.

Në muajin Mars është mbajtur trajnimi në fushën e treguesit gjeografikë për komisionin e ekspertëve për Kontrollimin e Produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë. Trajnimi u organizuar nga projekti IPR dhe u mbajt nga ekspertja turke Gonca Ilicali. Anëtarët e komisionit u trajnuan mbi procedurat e shqyrtimit të aplikimeve për treguesit gjeografikë.

Është mbajtur seminari për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të autorizuar në fushën e pronësisë industriale. Projekti i EU - Mbështetje e Pronësisë Intelektuale në Kosovë në bashkëpunim me Shoqatën e Përfaqësuesve të Autorizuar dhe Agjencinë për Pronësi Industriale organizuan seminarin për përfaqësuesit e autorizuar në fushën e pronësisë industriale.




Është mbajtur takimi i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale në Muajin Prill. Takimi u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Zyrës për të Drejtat Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përfaqësuesi nga Dogana e Kosovës, Inspektorati i Tregut, Gjykata, përfaqësuesi i projektit të EU - IPA 2017, përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, dhe Policia e Kosovës. Në takim u diskutua mbi raportin e punës të Institucioneve pjesë të Këshillit Shtetëror, raporti i punës së Këshillit dhe planin e punës për vitin 2021, me theks forcimin e koordinimit ndërinstitucional të njësive që merren me pronësinë intelektuale në Kosovë.

U shënuar Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale. Më 26 Prill të çdo viti, festohet Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale, për të promovuar rëndësinë e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale. Për këtë vit Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), zgjodhi të festoj me moton: "Pronësia Intelektuale dhe Biznesi". Për shënimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Agjencia organizoi disa aktivitete. Aktivitetet janë organizuar në mënyra jo-tradicionale për shkak të masave anti-covid, ku kryesisht promovimi i pronësisë industriale është bërë përmes platformave elektronike apo pjesëmarrje në televizione kombëtare.

IP and SMEs:  
**Taking  
your ideas  
to market**

World Intellectual  
Property Day 2021  
April 26

#worldipday  
wipo.int/ipday



### Aktivitetet e mbajtura për shënimin e ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale përfshinë:

Pjesëmarrje në emisionin e mëngjesit në Radio Televizionin e Kosovës



Pjesë e tryezës për të drejtat e pronësisë intelektuale organizuar nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Agjencinë për Pronësinë Industriale, ku u fol dhe u dhanë sqarime për publikun lidhur me rëndësinë e mbrojtës së pronësisë industriale dhe prezantoi të arriturat gjatë vitit 2020 dhe sfidat për vitin 2021.

Lansimi i videove promovuese për pronësisë intelektuale. Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, përgatitur nga Projekti i EU në bashkëpunim me institucionet ndërlidhëse të fushës së pronësisë intelektuale, u lansuan videot promovuese “Pronësia Intelektuale Funkcionon”. Videot mund ti gjeni në linkun: <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,12>



Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale shënohet me datë 26 prill, të çdo viti. Për t'i dhënë dritë kësaj dite, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi forumin e saj virtual të radhës, ku u diskutua për PI & NMV-të: Plasimi i ideve në treg. Pjesë e panelit për të diskutuar rreth rolit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në ekonomi dhe mënyrës së si mund të përdorën të drejtat e pronësisë intelektuale nga bizneset, ishin përfaqësuesit e Agjencisë për Pronësi Industriale, Doganës së Kosovës, dhe Ekspertë të IPR.





Pasditja në Radio Televizionin 21 me Pronësinë Intelektuale. Promovimi i Pronësisë Industriale dhe rëndësia e mbrojtjes së identitetit të produktit me markë tregtare apo objekte tjera të PI.

Prona Intelektuale pjesë e programit të mëngjesit në Kohavision me rastin e shënimit të Ditës Botërore të pronësisë Intelektuale.

Disa studentë nga Universiteti Francez – AgroParisTech tek vizituan Agjencinë për Pronësi Industriale. Studentët janë duke realizuar një projekt së bashku me Institutin e Kosovës për Pronësi Intelektual mbi hulumtimin e aplikimin të djathit të sharrit si tregues gjeografikë.




Finalizimi i reformës ligjore në fushën e pronësisë industriale. Me mbështetjen e projektit IPR të BE, u mbajt punëtori për finalizimin e projek ligjeve në fushën e pronësisë industriale. Në këtë punëtori morën pjesën përfaqësuesit e projektit IPR, personat përgjegjës për draftimin e projektligjeve, përfaqësuesit e Departamentit Ligjor të MINT dhe menaxhmenti i Agjencisë.

Së bashku me projektin e IPR të BE janë finalizuar 5 Projektligje: Projektligjit për Patenta, Projektligji për Marka Tregtare, Projektligjit për Sekretin Tregtar, Projektligji për Dizajnin Industrial dhe Projektligji për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topogafisë së Qarqeve të Integruara. Miratimi i këtyre projektligjeve përfundon reformën ligjore dhe ligjet e miratuara do të jenë në përputhje të plotë me Acquis e BE.



U publikuan librat komikë për Marka Tregtare dhe Patenta. Me mbështetjen e projektit të EU për pronësinë intelektuale, u publikuan librat komikë për marka tregtare dhe patenta. Këto libra ofrojnë informata mbi njohuritë themelore mbi këto objekte të pronësisë industriale përmes ilustrimeve me fotografi. Për ti shkarkuar këto libra klikoni në linkun <https://kipa.rks.gov.net/page.aspx?id=1,49>





Me ndihmën e projektit të EU, IPR Project, janë mbajtur disa trajnime, seminare dhe punëtori në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative për zyrtarët e Agjencisë për Pronësi Industriale dhe institucioneve tjera dhe promovimin e pronësisë intelektuale.

Trajnim mbi zbatimin e Pronësisë Industriale me Inspektorë të Inspektoratit të Tregut dhe zyrtarë të Agjencisë për Pronësi Industriale.



Trajnim mbi pronësinë industriale për Drejtorinë e Hetimit, Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e Kosovës, organizuar nga Projekti IPR – EU.






Trajnimi 2 ditor i zyrtarëve të Agjencisë mbi procedurat e shqyrtimit të kundërshtimeve dhe shfuqizimeve të markave tregtare. Gjatë këtij trajnimi, organizuar nga projekti IPR-EU, u ligjërua mbi zhvillimin e procedurave për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe shfuqizimeve dhe u trajtuan disa kërkesa të pranura në Agjenci, të cilat do të shërbejnë si mostër në trajnimin dhe vënien e një praktike procedurale në shqyrtimin e kundërshtimeve dhe kërkesave për shfuqizimin e markave tregtare. Mbjajtja e punëtorisë së përbashkët e anëtarëve të task-forcës kundër falsifikimit dhe piraterisë



Janë mbajtur 2 trajnime me mbështetjen e projekti IPR, në fushën e komunikimit me publikun. Në trajnim kanë marrë pjesë zyrtarët e Agjencisë, përfaqësuesit e institucioneve në fushën e IPR dhe trajnimi i veçantë për përfaqësuesit e autorizuar në fushën e pronësisë industriale.



Janë publikuar doracakët për patenta, marka tregtare dhe dizajn industrial. Projekti i EU, IPR projekt ka përgatitur doracakët për objektet e pronësisë industriale. Qëllimi i përgjithshëm i publikimit të tyre është të rrisë ndërgjegjësimin e bartësve të të drejtave dhe të shoqërisë në përgjithësi për rëndësinë e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale. Për hapjen e doracakëve kliko: <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49>



Agjencia për Pronësi Industriale ishte pjesë e forumit organizuar nga Oda Amerikane e Kosovës. Në kuadër të shënimit të Javës Globale të Ndërmarrësisë, Oda Amerikane e Kosovës organizoi forum diskutimi mbi pronësinë intelektuale. Z. Dukaj foli mbi rëndësinë e pronësisë industriale, mbrojtjen e tyre dhe rëndësinë e objekteve të pronësisë industriale për bizneset në veçanti.






Është mbajtur takimi fillestar i grupit punues për hartimin e Strategjisë së Pronësisë Industriale. Draftimi i Strategjisë mbështetet nga projekti IPR – BE. Strategjia e Pronësisë Industriale 2022-2025 synon ndër të tjera ngritjen dhe forcimin e promovimit të pronësisë industriale, përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë industriale me qëllim nxitjen e inovacionit dhe kërkimit shkencor.



Trajnim i organizuar nga projekti IPR për Përfaqësuesit e Autorizuar në fushën e pronësisë industriale. Gjatë trajnimit u ligjerua mbi rolin e IP në biznese, regjistrimi ndërkombëtar i objekteve të pronësisë industriale dhe metodat e komunikimit me klientët.



Promovimi i Pronësisë Industriale në Jakova Innovation Center. Agjencia për Pronësi Industriale së bashku me projektin e EU, IPR Project dhe Zyrën për Drejtat e Autorit realizuan një aktivitet për promovimin e pronësisë intelektuale. Agjencia për Pronësi Industriale u përfaqësua nga zyrtarja për promovim, znj. Besa Rama, e cila prezantoi pronësinë industriale dhe në veçanti mbrojtjen e produkteve me markë tregtare, patentë apo dizajn industrial.



## 7. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **368,791.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar **6720** fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.



## **8. Sfidat**

Agjencia për Pronësi Industriale siç është theksuar vazhdimisht në raportet e KE dhe mekanizmave të tjerë, ka mungesa e resurseve humane dhe vepron me një buxhet të limituar për kryerjen e shërbimeve sipas mandatit të saj ligjor, andaj sfidat kryesore të saj janë:

1. Mungesa e një strukture e cila plotëson nevojat për mirë funksionimin e Agjencisë;
2. Numri shumë i vogël i zyrtarëve profesional apo ekzaminuesve;
3. Numri shumë i lartë i kundërshtimeve të pa shqyrtuara kundër regjistrimit të markave tregtare, të pa shqyrtuara të cilat barten që nga viti 2013;
4. Vetëdija e ulët e publikut për rëndësinë e pronësisë industriale;
5. Pamundësia për hyrjen Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale, për shkak të statusit politik.

## **9. Donatorët**

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. IPA 2017 Project “ EU Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, projekti 3 vjeçar i filluar në Tetor 2019, përfundon më 18 Tetor 2022.
2. Technical Assistance by Luxembourg-Development – projekti mbështet disa aktivitete në forcimin e kapaciteteve.